



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA			
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA			
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HEALTH			
Njesia Org. Org. Jedinica Org. Unit:	01	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.:	05-7490
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages:	-18-	Date: Datum: Date:	21/11/2023
Prishtinë / a			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health  
Zyra e Ministrit / Ured Ministra / Office of the Minister

**Nr.192/XI/2023**

**Datë: 20.11.2023**

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), nenin 11, paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nxjerrë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet Plani i veprimit për funksionalizimin e Hemodializës në objektin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec (2023 – 2025).
- II. Shtojcë e vendimit është Plani i veprimit për funksionalizimin e Hemodializës në objektin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec (2023 – 2025).
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

**Dr. Arben Viti**

**Ministër i Shëndetësisë**



**Vendimi i dërgohet:**

- Kabinetit të Ministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti ligjor;
- Departamenti ZhSSH;
- Arkivit të MSh-së;



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

**Plani i veprimit për funksionalizimin e  
Hemodializës në objektin e Qendrës  
Kryesore të Mjekësisë Familjare në  
Rahovec  
(2023 - 2025)**

Prishtinë, Tetor 2023

## Përmbajtja

1.	PERMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	4
2.	HYRJE .....	6
3.	METODOLOGJIA .....	7
4.	SFONDI.....	8
5.	OBJEKTIVAT.....	8
6.	ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT .....	12
7.	NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I STRATEGJISE .....	13

## Shkurtesat

ASK	Agjensia Kosovare e Statistikave
DShPS	Drejtoria Shëndetësore për Përkujdesje Sociale
EKG	Elektrokardiogram
EVM	Edukimi Vazhdueshëm Mjekësor
HD	Hemodializë
KASH	Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve
KDSh	Kujdesi Dytësor Shëndetësor
KPSh	Kujdesi Parësor Shëndetësor
KTSs	Kujdesi Tretësor Shëndetësor
MSh	Ministria e Shëndetësisë
Nr	Numër
PSO	Procedura Standarde Operative
PV	Plani Veprimit
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
SP	Spitali i Përgjithshëm
SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës
UA	Udhëzim Administrativ
ZhVP	Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

## 1. PERMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Rreth 12% e popullatës botërore vuan nga sëmundja kronike e veshkave. Sot në botë pacientë me insuficiencë renale kronike që trajtohen me dializë janë mbi 1.000.000.

Numri i pacientëve që kanë nevojë për një trajtim të tillë po rritet në vazhdimësi, por arritjet teknologjike mundësojnë vazhdimin e jetës të këta të sëmurë deri 20 vite. Sipas teknikës në përdorim janë dy lloje të dializës: Hemodializa dhe dializa peritoneale (DP). Hemodializa është forma më e zakonshme e mjekimit me dializë e cila zbatohet duke përdorë aparatet e veshkës artificiale.

Në Republikën e Kosovës për herë të parë në vitin 1978 ka filluar trajtimi i të sëmurëve me terapi zavendsuese renale – Hemodializë. Me kalimin e viteve një trajtim i tillë ka filluar edhe në spitalet regjionale, në vitin 1980 në SP të Mitrovicës, më 1986 në SP të Prizrenit, më 1987 në SP të Gjilanit, më 1990 në SP të Pejës, në vitin 2003 në SP të Gjakovës, në vitin 2009 në SP të Ferizajit dhe në vitin 2014 ka filluar në Klinikën e Pediatriisë në QKUK në Prishtinë. Në kuader të Klinikës së Nefrologjisë ofrohen dy shërbime të HD, njëra brenda objektit të ish-Klinikës Interne dhe tjetra HD-II në objektin e QMF në lagjen Kodra e Trimave në Prishtinë. Me 26.06.2010 është hapur kjo qendër satelit në lagjen Kodra e Trimave. Qendra satelit e HD në lagjen Kodra e Trimave për momentin funksionon në dy ndërrime ku ju ofrohen shërbime pacientëve të kësaj lagje, pacientëve nga Komuna e Podujevës dhe ajo e Fushë Kosovës.

Në Klinikën e Nefrologjisë përfshirë edhe qendren e HD-II, vetëm në vitin 2022 janë kryer gjithsej rreth 40.000 seanca të HD, dhe kjo është një arsye më shumë për të funksionalizuar HD në objektin e QKMF në Rahovec. Plani i Veprimt për funksionalizimin e HD në objektin e QKMF në Rahovec, ka për qëllim marrjen e masave në ofrimin e shërbimeve në këtë qendër. Iniciativa ka nisur në vitin 2014, për të vazhduar me pas deri në funksionalizim. Në vitin 2017 janë zhvilluar një varg aktivitete, të cilat kishin për qëllim krijimin e kushteve për ofrimin e këtij shërbimi si dhe furnizimi me pajisje specifike për këtë shërbim nga donatori.

Poashtu është bërë planifikimi i burimeve njerëzore i cili është i miratuar nga SHSKUK-ja, vendimi 14/2017 i datës 19.01.2017 nr. prot.60, edhe përkundër kushteve të krijuara, që nga ai vit shërbimi nuk u është ofruar pacientëve. Stafi i pranur për këtë qëllim ka vazhduar punën në SP të Prizrenit (6 infermiere dhe 1 serviser për momentin) kurse pajisjet vazhdojnë të mbeten në këtë qendër të papërdorura.

Me funksionalizimin e HD në objektin e QKMF në Rahovec, pritet që stafi të vazhdojë punën në HD në objektin e QKMF në Rahovec, për ku kanë qenë të dedikuar fillimisht (Raporti i aprovuar nga Ministri i Shëndetësisë me nr. prot. 05-6334, datë 10.10.2023)

Gjatë periudhës së pandemisë objekti në fjalë është shfrytëzuar për vaksinimin e qytetarëve kundër Covid-19.

Komuna e Rahovecit gjendet në aspektin administrativ në regjionin e Gjakovës, mirëpo për shkak të mungesës të burimeve njerëzore në SP të Gjakovës, ku funksionon vetëm një (1) specialist – Internist, është e pamundur që qendra satelit të menaxhohet nga ky spital. Andaj me qëllim të funksionalizimit të HD në objektin e QKMF në Rahovec, në vitin e parë të punës obligohet SP Prizren të menaxhojë këtë shërbim jorezident, ndërsa nga viti pasardhës e tutje menaxhimi realizohet nga SP Gjakovë.

Është realizuar vlerësimi nga Komisioni për vlerësimin hapësirave brenda dhe jashtë objektit, si dhe paisjeve dhe inventarit ekzistues dhe të atyre të parapara për HD në objektin e QKMF në Rahovec (Raporti me nr. prot. 05-6243. Datë 06.10.2023).

Funksionalizimi i kësaj HD do të bazohet në modelin e funksionimit të qendrës satelit në QMF në lagjen Kodër e Trimave në Prishtinë, e cila udhëhiqet nga Klinika e Nefrologjisë në QKUK.

Me qëllim të qëndrueshmërisë së HD në objektin e QKMF në Rahovec, kërkohet marrëveshja në mes të MSH, SHSKUK (SP Prizren dhe SP Gjakovë), IKSHPK dhe Komuna e Rahovecit.

## 2. HYRJE

Numri i pacientëve të cilët vuajnë nga sëmundjet kronike të veshkave është në rritje nga viti në vit në vendin tonë edhe në botë. Pacientët të cilët vuajnë nga sëmundja kronike e veshkave dhe trajtohen me terapi zëvendësuese renale në Kosovë është mbi 800 pacientë. Trajtimi me terapi zëvendësuese renale - Hemodializë, realizohet tri (3) herë në javë nga katër (4) orë në qendrat përkatëse.

Në QKUK në Klinikën e Nefrologjisë në Prishtinë, në program të rregullt të HD në të dy shërbimet (I dhe II) janë mbi 220 pacientë. Zhvillimi i kapaciteteve dhe riorganizimi i qendrave të reja të Hemodializes në Republikën e Kosovës synon të zhvilloj shërbim me adekuat për pacientët.

Trajtimi me terapi zëvendësuese renale - Hemodializë kontribuon mjaft në kujdesin shëndetësor, dhe përgjegjësi e gatishmëri të stafit shëndetësor ndaj sfidave të këtij trajtimi.

Në këtë kontekst, involvohen një staf i gjerë ku përfshihen profesionistë të ndryshëm shëndetësor si: Nefrolog, Internist, Kirurg Vaskular, Mjek Familjar, Specializant të mjekësisë, infermier/e, instrumentare, ingjinerët-teknikët e aparaturave, higjienistët, bartësit, serviret, rojet, etj.

Duke marrë për bazë praktikën e vendeve partnere të cilat e kanë të zhvilluar këtë shërbim dhe rekomandimet e tyre, synojmë të jemi me afër qytetarëve me ofrimin e këtij shërbimi.

Funksionalizimi i HD në objektin e QKMF në Rahovec është domosdoshmëri e kohës, duke pasur parasysh që Komuna e Rahovecit ka nevojë që të ju ofrojë këtyre të sëmurëve një trajtim të tillë.

Gjatë hartimit të Planit të Veprimt (PV), u konsultuan edhe dokumente të tjera përkatëse, si: Ligji 04/L-125 për shëndetësi, Ligji 04/L-150 për odat e profesionistëve të kujdesit shëndetësor; Ligji 05/L-024 për shërbimin mjekësor emergjent, Ligji nr.2004/38 për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor, Ligji nr.02/L-38 për inspektoriatin shëndetësor, Plani Kombëtar për Zhvillim 2030, Draft Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2023-2030, UA - Nr. 06-2015 Kushtet e përgjithëshme dhe të veçanta spitalore, UA - Nr.11/2013 sistemi i informatave shëndetësore dhe raportimi i të dhënave statistikore

Zbatimi i PV kontribuonë në rritjen dhe promovimin e cilësisë, efektivitetit dhe sigurisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Andaj, funksionalizimi i HD në objektin e QKMF në Rahovec do të ndikon pozitivisht në shëndetin afatgjatë të popullatës së Kosovës.

### **3. METODOLOGJIA**

Plani i Veprimit për funksionalizimin e HD në objektin e QKMF në Rahovec është hartuar duke u bazuar në metodologjinë e përcaktuar në Udhëzimin Administrativ (UA) (QRK) 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit. Plani është hartuar nga grupi punues i emëruar me Vendim nga Sekretari i Përgjithshëm i MSH, me nr. protokolli 05-3681 të datës 14.06.2023.


Për përgatitjen e planit janë shqyrtuar të dhëna të bazuara në dëshmi nga Klinika Nefrologjike në QKUK në Prishtinë dhe SP Prizren.

Drafti final i Planit të Veprimit i dorëzohet MSH për miratim.



#### 4. SFONDI

Republika e Kosovës ka sipërfaqe prej 10.908 km<sup>2</sup>. Kosova ka gjithsej 38 komuna me 1.469 vendbanime të organizuara sipas ligjeve të vendit. Sipas vlerësimit të Agjencisë Kosovare të Statistikave (ASK) për vitin 2019, numri i përgjithshëm i popullsisë në Kosovë është 1,782,1151. Kosova karakterizohet me strukturë të re të popullsisë, ku mosha mesatare është 30.2 vjet. Bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë, rreth 61% e popullsisë jeton në zonat rurale, kurse 38% në zonat urbane.



Graf. 1 - Piramida e popullsisë sipas vlerësimit të popullsisë për vitin 2019

Gjendja shëndetësore e popullatës në Kosovë<sup>1</sup>, në vitin 2020 nataliteti në Kosovë ishte 11.9%, mortaliteti ishte 8.0% dhe shtimi natyror i popullsisë ishte 3.9%<sup>2</sup>. Të dhënat e fundit tregojnë se numri i përgjithshëm i vdekjeve në vitin 2019, në Kosovë është 9.430 ndërsa koeficienti i mortalitetit është 5.3 të vdekur në 1000 banorë<sup>3</sup>.

Shërbimi i Hemodializës në Republikën e Kosovës funksionon në: Klinikën e Nefrologjisë në QKUK dhe Hemodializës II në lagjen Kodra e Trimave në Prishtinë, SP Prizren, SP Gjakovë, SP Pejë, SP Ferizaj, SP Gjiilan dhe SP Mitrovicë.

Të sëmurët të cilët vuajnë nga sëmundja renale kronike dhe janë në program të rregullt të HD në Kosovë janë në rritje përafërsisht 5% nga viti në vit. Duke pasur parasysh natyrën e sëmundjes dhe trajtimin e kësaj patologjie është i domosdoshëm dhe jetike funksionalizimi i qendrës së HD në objektin e QKMF në Rahovec.

<sup>1</sup> Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, Agjencia Kosovare e Statistikave, 2020

<sup>2</sup> ASK Statistikat e lindjeve dhe vdekjeve 2020

<sup>3</sup> ASK, Statistikat e vdekjeve, 2019

Shërbimet shëndetësore në Kosovë ofrohen nëpërmjet rrjetit të institucioneve shëndetësore të organizuara në tre nivele: Kujdesi Parësor Shëndetësor (KPSH), Kujdesi Dytësor Shëndetësor (KDSH) dhe Kujdesi Tretësor Shëndetësor (KTSH).

Stafi që ofrojnë shërbime nefrologjike në institucionet shëndetësore në Kosovë, janë:

- Klinika e Nefrologjisë: 13 Internist-Nefrolog dhe 1 Internist, 66 infermier/e, 6 teknik të aparaturave;
- SP Prizren: 4 specialistë (3 Internist-Nefrolog dhe 1 Internist), 36 infermier/e, 4 teknik të aparaturave (prej tyre 6 infermier/e dhe 1 teknik i aparaturave, janë të pranuar për qendrën e Rahovecit por që shërbejnë në Spitalin e Prizrenit);
- SP Gjakovë: 1 specialistë - Internist, 20 infermier/e dhe 3 teknik të aparaturave;
- SP Ferizaj: 2 specialistë (1 Internist-Nefrolog dhe 1 Internist), 14 infermier/e dhe 2 teknik të aparaturave.
- SP Gjiilan: 2 specialistë - Internist, 13 infermier/e dhe 3 teknik te aparaturave;
- SP Pejë: 2 Internist-Nefrolog (njeri ka dal ne pension por është angazhuar edhe më tutje në mungesë stafi), 19 infermier/e dhe 3 teknik te aparaturave;
- SP Mitrovicë: 2 specialistë (1 Internist-Nefrolog dhe 1 Interniste), 13 infermier/e, 2 teknik te aparaturave.

Duke ditur rëndësinë e sigurimit të shërbimeve për HD, MSH vendosi të inicioj funksionalizimin e HD në objektin e QKMF në Rahovec.

Me qëllim të funksionalizimit të HD në objektin e QKMF në Rahovec është bërë planifikimi i burimeve njerzore i cili duhet miratuar nga MSH dhe SHSKUK:

- 1 menaxher/e i HD në objektin e QKMF në Rahovec (jo rezident);
- 1 kryeinfermier/e;
- 2 mjek;
- 5 infermierë;
- 1 higjienistë;
- 1 bartës;
- 2 serviserë të aparaturave.

Me qëllim të funksionalizimit të HD në objektin e QKMF në Rahovec duhet të sigurohet që SHSKUK (SP Gjakovë dhe SP Prizren) në bashkëpunim me MSH, Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe DSHPS në Komunën e Rahovecit, të ketë:

- Mjek specialist dhe/ose mjek specializantë të trajnuar në procedurat e nefrologjisë. Në vazhdimësi të ndjeken trajnime në nefrologji.
- Infermierë të trajnuar në nefrologji. Në vazhdimësi të ndjeken trajnime në nefrologji.
- Stafin e mirëmbajtjes për pastërtinë e HD në objektin e QKMF në Rahovec.

Realizimi i punës në HD në objektin e QKMF në Rahovec, sipas përlllogaritjes të bërë në raport me burimet njerëzore/ shtretërit/kohën (orarin), brenda një jave:

- Orari i punës nga ora 07.00 - 16.00 (turni I-rë = 07.00 - 12.00 dhe turni II-të = 12.00 - 16.00)
- 2 turne/ditë x 9 pacientë/ditë = 18 pacientë të trajtuar/ditë;
  - 18 pacientë të trajtuar/ditë x 6 ditë = 108 pacientë/javë.
    - 52 javë x 108 pacientë/javë = 5.616 shërbime të dializës të trajtuar brenda vitit.

Me qëllim të funksionalizimit të HD në objektin e QKMF në Rahovec, SHSKUK duhet të siguroj materialin/pajisjet mjekësore shpenzuese bazuar në UA - Nr. 06-2015 Kushtet e përgjithëshme dhe të veçanta spitalore. Po ashtu duhet të sigurohet servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e të gjitha pajisjeve mjekësore nga operatorët ekonomik të licencuar.

HD në objektin e QKMF në Rahovec duhet të bazohet dhe të zbatohet Udhërrëfyesit Klinik dhe Protokolet Klinike konform Udhëzimit Administrativ në fuqi.

Me qëllim të funksionalizimit të HD në objektin e QKMF në Rahovec, shpenzimet për komunalitetin i bartë Komuna e Rahovecit, ndërsa të gjitha shpenzimet tjera mbesin barrë e SHSKUK-së, njëherit SHSKUK obligohet të siguroj:

- burimet njerëzore për HD në objektin e QKMF në Rahovec sipas kodit të aprovuar për punësimin e tyre (theksuar në raportin e aprovuar nga Ministri i Shëndetësisë, Dr.Arben Vitia me nr.prot. 05-6334, datë 10.10.2023)
- stimulimin financiar shtesë për të gjithë punonjësit që do të ofrojnë shërbimet profesionale,
- mjetet e nevojshme për mirëmbajtjen e rregullt të aparaturave si dhe pajisjeve përcjellëse.

## 5. OBJEKTIVAT

Plani i Veprimit për funksionalizimin e HD në objektin e QKMF në Rahovec në sistemin e kujdesit shëndetësor të Kosovës në vitin 2023, synohet të zbatohet përmes:

### Objektivi strategjik

- Funksionalizimi i HD në objektin e QKMF në Rahovec për qytetarët e Komunës së Rahovecit.

### Objektiva specifike

- Ofrimi i shërbimeve profesionale në HD në objektin e QKMF në Rahovec.

Këto objektiva synohen të zbatohen përmes aktiviteteve si në vijim:

- Vlerësimi i hapsirave ekzistuese mbrenda dhe jashtë objektit në HD në objektin e QKMF në Rahovec;
- Vlerësimi i pajisjeve ekzistuese;
- Sigurimi i pajisjeve shtesë të nevojshme;
- Sigurimi i stafit të specializuar për ofrimin e shërbimit;
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional dhe Edukimi i Vazhdueshëm Mjekësor;
- Ofrimi i shërbimeve shtesë;
- Mirëmbajtja e pajisjeve.

## 6. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

Realizimi i aktiviteteve për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të Veprimit për funksionalizimin e HD në objektin e QKMF në Rahovec, do të mundësojnë sigurimin e të dhënave të bazuara në dëshmi lidhur me arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë dokument. Qëllimi i monitorimit është ofrimi i raporteve lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit, sipas të dhënave zyrtare, të cilat do të shërbejnë për vendime të bazuara në dëshmi për MSH-në.

Bazuar në indikatorët kyç të definuar në Plan të Veprimit, monitoron indikatorët sipas periudhës dhe frekuencës së përcaktuar dhe raporton në MSH duke siguruar që institucionet dhe departamentet përgjegjëse të ofrojnë llogaridhënie në rast të moszbatimit të detyrave dhe aktiviteteve të planifikuara.

Ky proces do të ndikoj në ndryshimin dhe plotësimin vjetor të Planit të Veprimit. Parim udhëheqës gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit është gjithëpërfshirja, ku në proces të monitorimit dhe vlerësimit do të përfshihen të gjithë akterët dhe institucionet hisedare në këtë fushë përmes shfrytëzimit të kapaciteteve institucionale, procedurave të brendshme dhe mekanizmave tjerë administrativë që lidhin dhe mundësojnë komunikimin e institucioneve shëndetësore mes vete. Në këtë proces, theksi është vënë në përdorimin e mekanizmave ekzistues për mbledhjen, agregimin, analizën dhe diseminimin e të dhënave në kuadër të Ministrisë dhe institucioneve tjera të përfshira. Ky dokument përfshin një numër të indikatorëve në nivele të ndryshme të zbatimit për periudhën kohore të përcaktuar në dokument, duke shfrytëzuar burime të informatave, raportime në periudha të rregullta përmes strukturave të përcaktuara të procesit të monitorimit.

Raportimi i zbatimit të aktiviteteve, sfidave eventuale dhe rekomandimet për ndryshime, do të jenë periodike dhe me kohë. Kjo do të mundësojë adresimin në kohën e duhur nga gjetjet e raporteve, për qëllim orientimin e politikave për shërbimet e ofruara në HD në objektin e QKMF në Rahovec .

Rezultatet e pritura nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të mundësojnë edhe ofrimin e informatave kthyesë efektive dhe me kohë për të gjitha grupet e interesit, ofrimin e raporteve të performancës së tyre, raportet fillestare ku janë të përcaktuara vlerat bazë të treguesve krahasuar me vlerat e pritshme dhe të dëshirueshme, raportet periodike të progresit si dhe raportet vjetore të performancës.

Vlerësimi përfundimtar i dokumentit do të ofroj të dhëna të bazuara në dëshmi të cilat do të shfrytëzohen si bazë për përcaktimin e kahjeve strategjike në periudhat e ardhshme si dhe hartimin e dokumenteve tjera në vazhdimësi. Raportimi i monitorimit të progresit, zbatimit dhe arritjeve të Planit të Veprimit do t'i prezantohet të gjitha institucioneve hisedare si dhe instancave përkatëse në baza të rregullta dhe kur është e nevojshme edhe publikut.

## **7. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT**

Zbatimi i Planit të Veprimit për funksionalizimin e HD në objektin e QKMF në Rahovec, paraqet sfidë institucionale për sektorin e shëndetësisë dhe të gjitha palët e përfshira, marrë parasysh burimet njerëzore në dispozicion si dhe burimet financiare. Megjithatë, MSH, SHSKUK dhe Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit për arritjen e objektivave, do të angazhohet dhe do të zbatojë një kombinim masash që përfshijnë përmirësimin e politikave dhe standardeve profesionale, promovimin dhe edukimin shëndetësor si mekanizëm për avancimin e shëndetit të qytetarëve në Komunën e Rahovecit dhe më gjerë, ndërtimin e kapaciteteve të profesionistëve shëndetësor për intervenimet e bazuara në evidencë, sigurimin e kushteve infrastrukturore dhe pajisjeve në HD në objektin e QKMF në Rahovec .

Referuar Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025 (KASh 2023-2025), SHSKUK obligohet që të paraqes dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2024.

## PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit për funksionalizimin e HD në objektin e QKMF në Rahovec								
Objektiva strategjike: Funksionalizimi i HD në objektin e QKMF në Rahovec për qytetarët e Komunës së Rahovecit								
Objektiva specifike 1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza 2023	Caku 2024	Caku 2025				
Ofrimi i shërbimeve profesionale në HD në objektin e QKMF në Rahovec.	Objektivat synohen të zbatohen përmes aktiviteteve si në vijim: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi i hapsirave ekzistuese mbrenda dhe jashtë objektit në HD në objektin e QKMF në Rahovec;</li> <li>- Vlerësimi i pajisjeve ekzistuese;</li> <li>- Sigurimi i pajisjeve shtesë të nevojshme;</li> <li>- Sigurimi i stafit të specializuar për ofrimin e shërbimit;</li> <li>- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional dhe Edukimi i Vazhdueshëm Mjekësor;</li> <li>- Ofrimi i shërbimeve shtesë;</li> <li>- Mirëmbajtja e pajisjeve.</li> </ul>	%	%	%				
Aktiviteti 1 (Hapsira & Pajisjet)	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		2023	2024	2025				
1.1 Hapsira për HD në objektin e QKMF në Rahovec	K - IV 2023	300,000.00€	0.00€	0.00€	K. Rahovec	DSHPS - K. Rahovec	MSH SHSKUK	Finalizimi i hapsirës me rreth 600 m <sup>2</sup>
1.2 Renovimi i hapsirave të HD në objektin e QKMF në Rahovec ( <i>dysHEMEJA, DYER, DRITARE, NYJET SANITARE, NDRIÇIMI, ETJ.</i> )	K - IV 2023	40,000.00€	0.00€	0.00€	K. Rahovec & SHSKUK	DSHPS - K. Rahovec	MSH SHSKUK	Kontraktimi i OE për renovim dhe finalizimin e objektit
1.3 Mirëmbajtja e hapsirës ( <i>KLIMATIZIMI, VENTILIMI, NYJET SANITARE, NGJYROSJA, SISTEMI I GAZRAVE DHE ELEKTRIKA</i> )	2024 - 2025	0.00€	30,000.00€	30,000.00€	K. Rahovec & SHSKUK	DSHPS - K. Rahovec	MSH SHSKUK	Mirëmbajtje e vazhdueshme

<p>1.4 Pajisjet për funksionalizimin e HD në objektin e QKMF në Rahovec (<i>aparartet për dializë me shtretër të HD me tavolinë (set); sterilizator i thatë; aspirator klinik; pompë e ujit; impianti ekzistues të Reverse Osmozës; peshorja multifunksionale për matjen e peshës së pacientit së bashku me karrocë</i>).</p>	K - IV 2023	250,000.00€	10,000.00€	10,000.00€	SHSKUK	SHSKUK	MSH DSHIPS - K. Rahovec	<p>Janë në HD:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 10 Aparate për dializë &amp; 10 Shtretër të HD me tavolinë (set);</li> <li>• 1 Sterilizator i thatë &amp; 1 Aspirator klinik;</li> <li>• 2 pompa të ujit.</li> <li>• Impianti ekzistues i Reverse Osmozës;</li> <li>• 1 Peshore Multifunksionale për matjen e peshës së pacientit së bashku me karrocën.</li> </ul>
<p>1.5 Aparati i Hemodializës në dhomën HCV - Hepatitis C virus.</p>	K - IV 2023	30,000.00€	1,000.00€	1,000.00€	SHSKUK	SHSKUK	MSH DSHIPS - K. Rahovec	I funksionalizuar
<p>1.6 Materiali shpenzues (<i>seti komplet</i>)</p>	K - IV	3,500.00€	480,000.00€	480,000.00€	SHSKUK	SHSKUK	MSH DSHIPS - K. Rahovec	I gjithë materiali shpenzues në dispozicion



1.7 Inventari medicinal (Autoklav, defibrillator, monitor, EKG, etj.)	K - IV	10,000.0 0€	2,000.00 €	2,000.00 €	SHSKUK	SHSKUK	MSH DSHPS - K. Rahovec	Inventari medicinal në dispozicion
1.8 Invetari jo medicinal (tavolina pune, karriga, dollapë, etj.)	K - IV	20,000.0 0€	1,000.00 €	1,000.00 €	DSHPS - K. Rahovec / SHSKUK / MSH	SHSKUK	MSH Donatorët	Inventari jo medicinal në dispozicion
1.9 Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e të gjitha pajisjeve mjekësore nga operatorët ekonomik të licencuar (10% e vlerës së produktit)	2023 - 2025	20,000.0 0€	20,000.0 0€	20,000.0 0€	SHSKUK	SHSKUK	MSH SHSKUK Donatorët	Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt në vazhdimësi nga Operatori Ekonomik i licencuar
1.10 Ushqimi	2023 - 2025	500.00€	20,000.0 0€	20,000.0 0€	SHSKUK	SHSKUK	MSH SHSKUK Donatorët	Sigurimi i rregullt i ushqimit
<b>Aktiviteti 2 (Burimet njerëzore)</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Kostoja totale</b>			<b>Burimi i financimit</b>	<b>Institucioni udhëheqës</b>	<b>Institucionet mbështetëse</b>	<b>Produkti</b>
		<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>				
2.1 Menaxheri i HD	2023 - 2025	0.00€	9,072,0.0 €	9,072,0.0 €	SHSKUK	SHSKUK	MSH	1 menaxher
2.2 Kryeinfermier (fillimisht nga QKUK)	2023 - 2025	0.00€	7,938.00 €	7,938.00 €	SHSKUK	SHSKUK	MSH	1 kryeinfermier
2.3 Mjek	2023 - 2025	0.00€	30,240,0. 0€	30,240.0 0€	SHSKUK	SHSKUK	MSH	2 mjek
2.4 Infermierë	2023 - 2025	0.00€	34,650.0 0€	34,650.0 0€	SHSKUK	SHSKUK	MSH	5 infermierë
2.5 Bartësi	2023 - 2025	0.00€	4,836.00 €	4,836.00 €	SHSKUK	SHSKUK	MSH	1 bartës
2.6 Serviser i aparaturës	2023 - 2025	0.00€	12,852,0 0€	12,852.0 0€	SHSKUK	SHSKUK	MSH	2 serviser
2.7 Higjienistë	2023 - 2025	0.00€	4,788.00 €	4,788.00 €	SHSKUK	SHSKUK	MSH	1 higjienistë

Aktiviteti 3 (ZHVP & EVM)	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		0.00€	10,000.00€	10,000.00€				
3.1 Trajnimi i vazhdueshëm mjekëve	2024 - 2025	0.00€	10,000.00€	10,000.00€	SHSKUK Odat Donatorët	SHSKUK	MSH Odat Donatorët	2 mjek (nga 3 muaj)
3.2 Trajnimi i infermierëve	2024 - 2025	0.00€	5,000.00€	5,000.00€	SHSKUK Odat Donatorët	SHSKUK	MSH Odat Donatorët	6 infermier të trajnuar (nga 3 muaj në QKUK dhe/ose 1 muaj jashtë vendit)
3.3 Pjesëmarrja në konferenca/simpoziume/kongrese/puntori	2024 - 2025	0.00€	7,500.00€	7,500.00€	SHSKUK Odat Donatorët	SHSKUK	MSH Odat Donatorët	2 mjek dhe 6 infermier
3.4 Trajnimi i vazhdueshëm i stafit mbështetës	2024 - 2025	0.00€	2,000.00€	2,000.00€	SHSKUK Odat Donatorët	SHSKUK	MSH Odat Donatorët	4 persona të trajnuar
3.5 Adaptimi / Hartimi i Udhërrëfyesve Klinik dhe Protokolleve Klinike, përfshirë monitorimin e zbatimit	2024 - 2025	0.00€	10,000.00€	10,000.00€	MSH Donatorët	SHSKUK	MSH Odat Donatorët	Udhërrëfyesi Klinik dhe Protokolli Klinik të hartuar.
3.6 Hartimi dhe monitorimi i zbatimit i PSO-së	2024 - 2025	0.00€	0.00€	0.00€	MSH Donatorët	SHSKUK	MSH Odat Donatorët	PSO e hartuar.
<b>Total:</b>		<b>674,000.00€</b>	<b>702,876.00€</b>	<b>702,876.00€</b>				
		<b>2,079,752.00 €</b>						